




KUVENDI I KOMUNËS-SUHAREKË
SKUPŠTINA OPŠTINE - SUVA REKA
MUNICIPALITY OF SUHAREKA



PROCESVERBAL VIII/2024

I mbajtur me rastin e mbledhjes së 8 (tetë) për vitin 2024 të Kuvendit të Komunës së Suharekës

Vendi: Suharekë
Zyra: Salla e Kuvendit të Komunës
Data: 30.08.2024
Ora: 10.00

Prezentë në takim:

Z. Shefket Kolgeci
Z.Selman Kolgeci
Z. Flamur Bytyqi
Z. Urim Suka
Z. Kushtrim Kuçi
Znj. Elmaze Bytyqi
Znj. Bulëza Kuçi
Znj.Doruntina Zenelaj
Z.Alban Berisha
z.Xhevshet Gashi
Z. Bexhet Kuçi
Z. Reshat Selimaj
Z. Lirim Qatani
Z. Aziz Bytyqi
Znj.Sanie Kuçi-
Rexhepaj
Znj.Fidaije Kukaj

Znj. Afërdita Morina
Z. Vullnet Luzhnica
Z.Edon Sadikaj
Znj.Saranda
Bajraktari
Znj.Mimoza Bajraktari
Znj.Festë Kabashi
Z.Dardan Berisha
Z.Bajram Basha
Znj.Mevlude Kabashi
Znj.Sheqerije Zyrapi
Znj.Laureta Tafaj
Z.Liridon Fandaj
Z.Qëndrim Elshani
Z.Herolind Limaj
Znj.Jehona Lumi-
Rrafshi

Të pranishëm të tjerë

Kryetari Komunës
Media dhe qytetarë
OSCE, LMT, KDI
Znj.Habibe Bytyqi
Z.Xheladin Sadikaj

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi, Kryesuesi i Asamblesë Komunale z.Bexhet Kuçi,i cili propozoi këtë:

REND DITE

1. **Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
2. **Shqyrtimi i projekt-vendimit për shfuqizimin e vendimit 01-Nr-016-74231;**
3. **Shqyrtimi i projekt-vendimit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës;**
4. **Shqyrtimi i projekt-vendimit për këmbimin e pronës komunale me pronën private;**
5. **Shqyrtimi i projekt-vendimit për dhurimin e llaptopave;**
6. **Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës;**
7. **Shqyrtimi i projekt-vendimit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës;**
8. **Pyetje dhe përgjigje;**

Urim Suka - kur jemi te rendi i ditës në bazë të planit të punës së Kuvendit për këtë mbledhje ka qenë e paraparë që DKA të përgadis një raport dhe ta informojë Asamblenë për punën dhe aktivitetin e saj.E kemi diskutu edhe në KPF dhe duam ta dimë pse nuk po zbatohet ajo që e kemi në plan pune dhe a mundet me u përgadit në mbledhejn e ardhshme?

Kryesuesi - është e vërtetë që e kemi diskutu në KPF dhe e kemi lënë të bisedojmë në Asamble. Drejtori është prezent dhe shpresoj që seancën e radhës e sjell në Asamble.Nëse ka diçka te pyetje dhe përgjigje mund ti drejtoheni Drejtorit të Arsimit.

Urim Suka - ne jemi të vetëdijshëm për mundësinë që e kemi te pyetje dhe përgjigje dhe në fakt kemi pyetje te pyetje dhe përgjigje mirëpo ne po kërkojmë të zbatohet plani i punës dhe një raport më të përgjithshëm.Nëse nuk e sillni një raport,tregoni pse por planin e punës është mirë ta implementoni.

Kryesuesi - e hedh në votim rendin e ditës.

Unanimisht Miratohet rendi i ditës

Pika 1.Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 1.

Unanimisht Miratohet Pika 1

Pika 2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për shfuqizimin e vendimit 01-Nr-016-74231;

Kryesuesi - jep sqarime sa i përket shfuqizimit të vendimit.

Laureta Tafaj - kolega në fjalë a nuk e ka ditë se është në të dy komisionet apo aq shumë sa nuk po dini ku me i qu anëtarët e partive të juaja?Pse me shfuqizu krejt vendimin për një anëtar të komisionit,a nuk mundet veq me ndërru apo ka edhe diçka tjetër këtu?

Kryesuesi - ne s'kemi mujt me ditë por te kolegu në fjalë a e ka ditë apo jo,nuk e di.Ndodhin këto gabime dhe ne po e shfuqizojmë.

Laureta Tafaj - pse duhet me shfuqizu krejt vendimin?

Avni Bytyqi - si zyrtar ligjor jep sqarime dhe thotë që vendimi shfuqizohet për arsye se ende nuk është kthyer konfirmimi i ligjshmërisë nga MAPL-ja dhe për këtë kemi kërkuar që ta shfuqizojmë në tërësi vendimin dhe ta formojmë komisionin tjetër.

Laureta Tafaj - a ka diçka tjetër për këtë vendim që ne nuk e dimë apo vetëm për këtë arsye?

Avni Bytyqi - ka asgjë tjetër përpos konflikt interesi Edoni për shkak se është të njejtën kohë në të dy komisionet.

Liridon Fandaj – kjo bëri një pyetje dhe ti mund të japësh sqarime në aspektin ligjor. Nuk është i pari vendim sepse ne kemi edhe vendime tjera që janë zëvendësuar.

Kryetari - është një rregullore që ka kalu në vitin 2012.Kënd të doni mund ta futni në komision.Është renditja por nuk na pranon ligjshmëria atje.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 2.

22 për, 3 kundër, Miratohet pika 2

Pika 3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës;

Kryesuesi - elaboron pikën dhe hap debatin.

Selman Kolgeci - fillimisht ndarja e poenave te kriteri i parë nuk është në rregull.Ky propozim është hedh në votim dhe është mirë të përmirësohen këto lëshime dhe pastaj të vendosen në votim.Përpos pronarit të parcellës me nr.1209/0 dhe 1210/0 kanë shpreh interes edhe dy aplikues të tjerë që nuk kanë as marrëveshje me pronarët e parcellave dhe as nuk janë pronarë të ndonjërës nga parcellat që kufizohen me pjesën të cilën Kuvendi e ka shpall si parcellë me interes publik.A kanë apliku vetëm me shtu numrin apo cili ka qenë qëllimi i aplikimit të tyre?A është bërë ndonjë krahasim në lidhje me përqindjen që investitorët iu japin pronarëve parcellave private dhe përqindjen me vendos si kusht minimal që do të duhej ti ofronin palët e interesuara.Nuk e di dikund që ka në Suharekë që me 27 % të ndërtimit ta jep dikush token.A vetëm pse është e Komunës po bëjmë kështu apo cila është arsyeja?Mendoj që në këtë rast është shkel interesi i Komunës dhe për këtë arsye kjo procedurë duhet të anulohet dhe duhet të hapet thirrje e re me aplikime të reja dhe kushte të reja.Çështje tjetër është që po e shohim që është hap një grope që i paraprinë fillimit të punimeve tjera të ndërtimit të objektit.Për atë objekt a është lëshu leje ndërtimore apo kush ka marrë leje për me hap atë gropë?Nëse nuk ka leje ndërtimore,a kemi drejtori të inspektoriatit,a kemi inspektor,a kemi drejtori të urbanizmit apo i kemi mshel sytë krejt? Pse komisionet tjera nuk po funksionojnë?siç është komisioni i Agit.Sipas informatës që kemi,ai e ka pagu një taksë komunale për leje dhe nëse ai na padit neve nesër,komuna ka me u detyru me pagu fitimin e humbur kompanisë.

Kryesuesi - sa i përket shqetësimit të parë që ngrite,unë iu referova raportit të komisionit dhe kryesuesi i komisionit Drejtori i Urbanizmit është prezent këtu ndërsa sa i përket komisionit të Agit,është duke funksionu,kanë pas takime.Mu ka adresu me një shkresë mua dhe i kemi kthi përgjigje.Unë nuk jam faktorë që mundem me definu përqindjen dhe shëndrrimin e banesave në lokale por është komisioni për këtë punë.

Selman Kolgeci - komisioni nuk është duke funksionu.Komisioni duhet me ardhë me një përfundim dhe nëse nuk pajtohet pala është çështje tjetër.

Qëndrim Elshani - sa i përket kësaj prone,në cilin lokacion bëhet fjalë?Nëse i referohemi asaj që na keni dërgu,aty veq kanë fillu punimet.A ka pëlqim për fillimin e punimeve dhe a ka leje rrënimi për objektin paraprak që ka qenë në atë lokacion?

Kryesuesi - ne po flasim për parcelën Nr 011-0 dhe a janë duke punu në këtë parcelë unë nuk e di por unë ju lus që të jemi në këtë parcelë dhe mos të dalim jasht parcelës.

Liridon Fandaj - kriteri 20%,në bazë të cilës kontratë referuese janë referu komisini që e kanë caktu një përqindje 20%.Nuk ka mundësi,me një lokacion aty deri tash në bazë të marrëveshjeve kanë shku 30 %

dhe 35% ndërsa prona komunale të jepet me 27%! Si ka mundësi që ai pronar që e ka aty me dal i pari! Kjo lëndë duhet të hetohet dhe të kontrollohet se në bazë të cilës kontratë është marrë parametri 20% për me u dhënë 27% ajo pjesë.

Kryesuesi - në KPF e kemi diskutu që ishte e caktuar min. dhe max. dhe minimum është 20%.

Liridon Fandaj - çdo marrëveshje i referohet kontratës së fundit në atë lokacion. Unë dua ta di, komisioni në bazë të cilit dokumentet e ka përcaktuar atë përqindje?

Flamur Bytyçi - unë kam një shqetësim dhe për deri sa jam pjesë e komisionit e kam ngrit edhe në komision këtë. Për deri sa ne japim tokë për ndërtim, pjesa e banorëve që kanë tokë mbrapa, a do ti bëhet zgjidhje për m'i hap rrugë atyre? Ne po i japim diku një tokë të Komunës dhe në anën tjetër i bllokojmë banorët mbrapa dhe të njëjtën kohë mund ti fusim edhe në konflikt pastaj. Ku është nda rruga për banorët mbrapa?

Visar Kuçi - po kanë rrugë, kanë çasje të gjitha parcellat. Çdo banorë, çdo parcellë, çdo bllok i ndërtimit me Hartë Zonale ka zgjidhje përjashtim parcellave minimale. Sa i përket pyetjes për komisionin nga Selmani, komisioni është votu në Asamble dhe ne si komision i kemi caktuar kriteret dhe për herë të parë Komuna e Suharekës po jep parcellë me 27 % dhe nëse votohet Komuna e Suharekës po përfiton si kurrë më herët prej pronës publike dhe ju sot duhet me festu. Ne si komision kemi qenë shumë të kordinuar dhe kriter bazë e kemi marrë kontratën e fundit të Agit me 20% që e ka dhënë. Sa i përket Agit, është stërzgjat komisioni, është komisioni i tretë por e kemi stërzgjat komuna. Pyti të tjerët paraprak çka kanë bo kur ia kanë dhënë pronën pa çasje në rrugë atij pronari privat dhe si e kanë dëmtuar pronën publike. Si ka qenë e detyruar komuna e Suharekës me dhënë me patjetër atë prone publike. Aq keq e kanë lënë por kemi me rregullu edhe atë. Komisioni jemi taku para tre jave ku i ka disa shqetësime pronari. Ne jemi të barabartë me investitorët. Më mirë e bëjmë me hapa të sigurtë dhe të bëhet mirë. Prona në fjalë ka leje rrënimi dhe në kuadër të lejës së rrënimit hiqen edhe themelet por unë nuk kam pa personalisht që ka podrum të qelën ose gërmim.

Selman Kolgeci - ka leje rrënimi por kush ka marrë leje për me hap atë grop aty?

Visar Kuçi - nuk jam në dijeni që ka podrum të hapur.

Selman Kolgeci - çështja e festimit që thotë drejtori, unë nuk kam arsye me festu dhe kush keni arsye, festoni. Unë kisha festu nëse pronën komunale dikush e kish vlerësuar me 31 e 35%. Përball asaj pronës ku ne sot jemi duke e shqyrtuar është 31% deri 35%. Te çështja e shqetësimit të pronarit të Agit, komisioni nuk është as psikolog e as doktor me u marr me shqetësime të tjerëve por ju keni me kry punën në korniza ligjore.

Visar Kuçi - jep sqarime sa i përket Agit.

Liridon Fandaj - mua më intereson se kush është investitori aty? Nëse investitori është dost i yti dhe i Kryetarit atëherë ju dy festoni. Nëse ti i referohesh një vendimi të Agit që ende s'ka përfunduar, e ke gabim. Ende nuk ka përfunduar dhe nuk dihet ende përqindja. Ti duhet me marrë për bazë kontratën e fundit dhe në bazë të kontratës së fundit merret përqindja. Pronën publike mos e jep për dostat tuaj.

Liridon Fandaj dhe Visar Kuçi tutje replikojnë njëri tjetrin.

Selman Kolgeci - shqetësimi im është pse ai komisioni nuk e kryen punën? Nëse i keni këto probleme, hajde t'ja rrisim kompetencat këtij komisioni nëse nuk ka kompetencë të mjaftueshme me idenë që me përfunduar këtë temë. Te çështja e përqindjes, sa përqind iu ka dhënë Benafit kur e ka ndërtuar objektin?

Visar Kuçi - është vlerë më e vogël se e Agit por nuk e di saktë.

Selman Kolgeci - a mundesh këtë përgjigje me ma dhënë zyrtarisht me email në afat prej 7 ditëve.

Visar Kuçi - të gjitha pronat i jep Asambleja komunale dhe ne e zbatojmë ligjin. Ne si kriter e kemi marrë për bazë Agin dhe Agi procedurat i ka përfunduar për dhënie dhe ka shku deri në paisje me leje por për shkak të ndarjes të pronës së komunës nuk u pajis me leje ndërtimore.

Liridon Fandaj - a e ke nda përqindjen?

Visar Kuçi - përqindjen e ka të ndane prej komunës 20.5.

Liridon Fandaj - mos e merr të Agit që nuk ka përfunduar por merre në atë rrethinë kontratën e fundit. Nëse ti nuk ke qenë në gjendje me vlerësuar është dasht me dërgu një vlerësues për atë pjesë dhe jo me dëmtu komunën. A ka mundësi zyrtarisht me ma sjell atë kontratë që ti ju ke referu si komision që e ke marrë 20 %?

Visar Kuçi - Agi ka kontratë dhe të gjitha procedurat i ka kryer.

Laureta Tafaj - Visar e vërtetë që puna e Agit s'ka përfunduar dhe është stërzgjat por për 20% ne jemi në dijeni se kur filluam komisionin tash,kemi shku kemi kërku kontrata të reja dhe nuk e kemi dhënë përfundimin 20% dhe kemi thënë që ndoshta mundemi me rrit nëse trendet e fundit kanë shku me rritje.Selman është e vërtetë që s'jemi as doktorr e as psikolog dhe ne jemi për të drejtat dhe të mirën e qytetarëve dhe nuk mund të bëjmë diçka që qytetari pastaj me na padit neve dhe me dal në kundërshtim me neve.

Selman Kolgeci - nuk është mandati juaj me luft psikologun e as doktorrin por është mandate juaj,i thashë edhe drejtorit që ti kryeni punët në suaza dhe korniza ligjore duke i respektu ligjet në fuqi.

Laureta Tafaj - ti nuk mundesh me kërku me na rrit mandatin për një punë të cilën ne e kemi marrë përgjegjësinë me ato mandate që i kemi.Nëse ka qenë aq e thjeshtë qysh ti po mendon,pse nuk ke ardhë në komision sepse të kam lut?

Urim Suka - e kuptoj pjesën që juve ju intereson vendimin për të cilin na ka ardhë me deviju dhe krejt debatin me bë për diçka tjetër se sa për vendimin për të cilin po flasim.Shumë pyetje që ngriti Selmani nuk morën përgjigje adekuate.Kur jemi te vendimi që po flasim,për mua është edhe një shqetësim plus që Drejtori i Urbanizmit thotë: unë nuk e kam pa që është hap gropa.Neve si asamblesita na ka ardhë një material ku kemi me marrë një vendim për me dhënë një parcelë ku aty shkruan që në vendimin që e marrim ne ka me u ndërtu një kompleks banesor afarist bashkë me ato parcelat ku është hap podrumi.Me çfarë procedure është hap ajo grop që drejtori nuk e ka pa?A ka leje ai që e ka fillu ndërtimin?Unë mendoj që s'ka dhe nëse s'ka,krejt kjo procedurë që ka fillu,del që është e përgaditur ku me shku,çka me bo dhe ku me dhënë dhe ne si asambleist jemi në situatë të vështir sepse ne duhet me qu dorën për një diçka që dikush e ka fillu moti me paramendim.Për deri sa është kështu,unë mendoj që ne në asnjë variant nuk duhet me dhënë lejen.Unë dua përgjegje adekuate dhe nëse nuk kemi përgjegje,le të tërheket ky vendim dhe të nisim procedura tjera pse kemi ardhë deri këtu dhe mos të biem në lajthitje ne për dikënd që e ka nis këtë vendim me sjell me paramendim.

Kryesuesi - sa i përket për me tërheq nuk kemi nevojë.Ne jemi duke bisedu për një numër parcele krejt tjetër.Ky vendim s'ka të bëj asgjë me parcelën tjetër mbi të.

Visar Kuçi - pronari i njëres prej parcellave në bllokun e ndërtimit në ZSHP 4 ka apliku për leje ndërtimore në Drejtorinë e Urbanizmit.Ia kemi refuzu lejen ndërtimore për shkak se prona e komunës është në pjesën fqinje të asaj parcele që ai ka apliku për leje ndërtimore.Arsyeja ka qenë që mos të dëmtohet prona publike e Komunës.Në rastë tjera i thojmë shko bën marrëveshje ose e ftojme palën.Në këtë rast është tokë e komunës dhe nuk kemi mujt me ftu palën ne si drejtori dhe e kemi paraqit pranë organeve tona dhe i kemi nis procedurat.Të njëjtën kohë njëri prej pronarëve ka apliku për leje rrënimi dhe e kemi pais me leje rrënimi.Nuk ka podrum të hapur.Drejtori tutje jep sqarime.

Urim Suka - ti po e konfirmon atë që unë po e ngris si shqetësim sepse ti po thua që ai ka apliku për leje dhe ne s'i kemi dhënë por në anën tjetër ju e keni lënë m'i vazhdu punimet ai përtej asaj që e ka lejen për rrënim.Nuk jam kundër,le të bëhet një ndërtim por pse dikënd po e favorizojm e dikënd jo.

Kjo parcelë që po e japim ne dhe ajo që është qel podrumi,kanë me u bo bashkë dhe ka me u bo një kompleks banesor.Kjo parcelë nuk është veq.Shqetësimi im është vetëm pse nuk i keni prit procedurat dhe le ta fillon mandej ndërtimin.Unë i them secilit asambleist të mos bëhemi palë e këtij vendimin që është nis me paramendim.

Visar Kuçi - unë e kam ndjek procedurën dhe prronin po e jap ndërtim.Podrumi nuk është qel.

Visar Kuçi dhe Urim Suka replikojnë njëri tjetrit.

Alban Berisha - sot po më pëlqen sepse ka ndiku Armendi që iu luta me interferu te drejtorat e tjerë.Po shihet që kanë nis me punu ma shumë dhe m'u kanë më të zellshëm.Për të kaluarën që e përmende që atëherë s'u bë asgjë e tash që po bëni ju,ne bashkë kemi qenë atëherë.Sa i përket pikës,kjo pikë është prit dhe u ditë që ka me qenë pak më e ndjeshme.Normal që merr pjesë edhe një anëtar i familjes p.sh. i afërm me pushtetin që për mua personalisht është normale dhe legjitime sepse ne jemi duke jetu me një sistem juridik demokratik që secili qytetar i ka të drejtat e barabarta para ligjit pavarësisht a i përket një partie politike,a i përket anëtar i familjes dikujt që është në pushtet sepse nuk mund të diskriminohet dikush nëse e ka vëllaun kryetar,nënkryetar,drejtor.Kisha qenë kundra nëse nuk i plotëson kriteret dhe është i

favorizuar para tjerëve por nëse është i barabartë para ligjit me krejt tjerët,nuk ka të keqe as te punësimi edhe te marrja e punëve.Nuk jam ekspert i fushës se a janë respektu krej rregullat por Visar duhet me qenë më i kujdesshëm dhe mos thuaj nuk e kam pa.Duke e ditë sa aktiv je dhe në rrugën kryesore mos me pa!

Visar Kuçi - ju informova dhe thashë s'ka podrum,u informova edhe prej zyrtarëve.Përfituesi kryesor është Visar Sokol Basha.

Alban Berisha - Kush janë aty investitorët?

Visar Kuçi - Visar Sokol Basha.

Alban Berisha - kush ka bërë kërkesë?

Visar Kuçi - Visar Sokol Basha.

Alban Berisha - ne këtu si asambleista e formojmë një komision prej të cilit kemi të drejtë me kërku përgjegjësi çdo seancë,edhe nëse nuk është në rend dite ne kemi të drejtë me kërku përgjegjësi te të ndryshmet.Edhe te çështja e Agit dhe te çështjet tjera duhet me pas një afat.Nuk mundemi me thënë s'po mundemi me rregullu.Nëse s'mundemi me rregullu,ligji e lejon m'u kthy në pikën zero çdo gjë por nuk guxon pafundësisht me shku çdo gjë dhe duhet me pas një afat.Duhet m'u kry kjo punë Visar dhe duhet me dhënë llogari këtu.

Dardan Berisha - Nuk ma merr mendja që ka qenë dasht me bo kaq shumë polemikë sepse nuk është parcella e parë të cilën jemi duke e dhënë ne.Ne plotësisht i besojmë komisionit të cilin e kemi formu në Kuvend,ku i gjithë komisioni ka votu pro në bazë të raportit që e kemi.Është shqetësim i banorëve mbi parcelën që jemi duke e dhënë.A kanë çasje në rrugë apo nuk kanë çasje?

Visar Kuçi - kanë çasje.Kjo pjesa 2900 m² ne kemi me vazhdu dhe duhet me vazhdu si komunë.Është një shirit që në të kaluarën është quajtur prroni dhe tash ka hy në bllok të ndërtimit.Ne duhet vetëm me përdor një kriter.Drejtori tutje jep sqarime.

Selman Kolgeci - Visar sinqerisht unë nuk e kuptoj këtë gjuhë kur thua që s'është podrum.E kuptoj gjuhën kur ti më përgjigjesh zyrtarisht dhe thua që këto janë koordinatat e objektit që ka qenë ekzistues.Në këto koordinata investitori ka të drejtë me i prish edhe themelet që rrjedhimisht i bie me u hap edhe podrumi.I lutna Drejtorit të Urbanizmit dhe Drejtoreshës së Inspeksionit le të na sjell këto letra.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 3.

16 për,9 kundër,Miratohet pika 3

Pika 4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për këmbimin e pronës komunale me pronën private;

Kryesuesi - e elaboron pikën dhe hap debatin.

Selman Kolgeci - edhe në seancën e muajit shkurt kur në Kuvend ka ardhë kërkesa për shqyrtim për shpalljen e interesit të përgjithshëm të kësaj parcelle,kemi thënë që jemi pro.Problemi qëndron që ky pushtet nuk e ka as idenë që para fillimit të investimit në rrugë duhet elaborat shpronësimi,duhet vlerësim për pjesën që po i merret pronarëve private,miratim nga pronarët për një gjë të tillë e mandej të fillohet me ndërtimin e rrugës pasi ti ketë përfunduar edhe hartimi i projektit.Problemi tjetër është që ju nuk po e trajtoni rrugën si interes publik,po e trajtoni vetëm një parcelë sepse po ta trajtonit rrugën si interes publik,duhet m'i trajtu edhe parcelat 1256/1,1256/4,1062/4,1062/5,819/3,817/7,817/2, e të gjitha parcelat tjera që prekin në këtë rrugë në atë mënyrë që vërtetë me u trajtu rruga Luigj Nilloka.Rruga Luigj Nikolla nuk e ka vetëm këtë kontest,i ka edhe kontestet tjera që i përmenda dhe ju e dini.Ju këtë rrugë po e trajtoni pjesërisht,po bëni ndërrim vetëm me një pronar dhe po e zgjidhni çështjen e kësaj rruge vetëm për një segment për të cilin segment më herët nuk keni mujt me dhënë leje ndërtimore.Me këto investime në rrugë e objekte tjera institucionale pa zgjidhur fillimisht statutin pronësor,po i bëni dëm taksave të qytetarit për shkak se ju e dini që ose duhet me i kompenzu me vonë ose kanë me përfundu në gjykatë që kanë me na marrë shumfish më shumë mjete siç është rasti palestrës sportive tek SHMTP "Skënder Luarasi" për të cilën drejtori pretendonte që ka me përfundu në favor të komunës çështja e pronës së SHMTP "Skënder Luarasi" ku është ndërtu një palestër sportive e cila ka qenë shumë e nevojshme por e keni ndërtu në pronë private.Po i lëni barrë të rëndë qeverisjes së ardhshme me këto veprime.Sa i përket

zhvillimeve në këtë rrugë,në një parcelë në rrugën për të cilën po flasim po ndërtohet një objekt dhe më interson të informohem nëse ai objekt ka leje ndërtimore.Në kohën kur është lëshu leja ndërtimore,parcela në të cilën po ndërtohet një objekt,a kishte çasje në rrugë?Dua të informohem nëse ka objekte tjera që po ndërtohen në qytet dhe nuk e kanë trajtuar çështjen e çasjes në rrugë.Çështja e ndërtimeve pa leje, tejkallimet eventuale të lejeve ndërtimore,dhënia eventuale ndërtimore duke mos respektuar kriteret e ndërtimit e distancat do ti trajtojmë në seancën tjetër por sa i përket trajtimit të pronave nëpër të cilat kalojnë rrugët kaq është përgaditja juaj e kaq është interesi juaj për pronën publike përkundër neve që ne jemi të interesuar njëmend interesin publik ta shohim si interes publik në të mirë të qytetarëve e në të mirë të planifikimit hapsinor e të zgjerimit të qytetit.

Kryetari - rruga Luigj Nikolla nuk është prej vitit 2018 as 2019.Nëse fillojmë sivjet me shpall tenderin për një rrugë ashtu si e parasheh ligji me bë shpronësimin,asnjëherë s'kemi me mujt me kry asnjë rrugë për arsye se sot me bë një kërkesë për shpronësim shkon më së paku 5-6 muaj deri sa të vjen një komision qeveritar.Atë që po e mendon,kjo është pronë private e një personi nga Semetishti që ka dal qe një kohë të gjatë.Në buxhetin 2017-2018 ka qenë.Edhe pushteti para nesh e ka vendos dhe s'ka mujt me kry,kemi vazhdu ne në 2019 por s'kemi mujt me kry dhe jemi detyru me marrë vendim me shpronësu.Pronari i parë që iu ka shpronësu ka qenë afër 5600 € ari.Ai paret i ka marrë por nuk është i kënaqur mirëpo është gjykata dhe le të vazhdon me gjykatë.Unë sa e di kjo pronë nuk ka të bëj me ndërtim për arsye se është një pronar i Semetishtit.Kur t'vendos komisioni qeveritar mund ti heqni dyshimet se nuk vendosim ne për këmbim të pronave.Kryetari tutje jep sqarime.

Visar Kuçi - për pikën që po bëhet fjalë,i ka fillu procedurat jasht asaj pjese që është dhënë një leje ndërtimore dhe ska të bëj me këtë.Është bë mirë sepse prej kycjes së rrugës Luigj Nikolla deri në Brigadën 123 ne e kemi zgjidh me këmbim.Kam dokument prej ministrisë dhe një palë është anku.Ministria më ka obligu me pais me leje ndërtimore dhe fillo me procedurat e shpronësimit por fatmirësisht procedurat e shpronësimit kanë fillu më herët.

Selman Kolgeci - e çmoj vullnetin e qytetarit që ka dhënë më shumë e ka marrë më pak.Nuk jeni në temë.Ne jemi pro për këtë rrugë dhe për krejt rrugët por çasja si është nis nuk është vetëm kjo parcelë pengesë në këtë rrugë.Pse nuk i keni ftu pronarët legjitim të pronave atje dhe m'i thane që po doni me rregullu çështjen e rrugës Luigj Nikolla dhe hajde po negociojmë.

Kryesuesi - ky ka bë kërkesë dhe këtë e kanë sjell.

Selman Kolgeci - e di por nuk po trajtohet përfundimisht statuti i rrugës Luigj Nikolla por po zgjidhet një segment i kësaj rruge.

Armend Krasniqi - çështja e shpronësimit është komplekse dhe është shumë problem me trajtu.Kemi qindra probleme me çështje të shpronësimit ku kemi shtru rrugë vend e pa vend por edhe Brigada 123 nuk ka shpronësim një pjesë.Drejtori tutje jep sqarime sa i përket procedurave të shpronësimit dhe problemeve që hasin gjatë procedurës së shpronësimit.Pajtohem që duhet me punu sipas projekteve me bo shpronësimin sepse s'kemi kod të veçantë të shpronësimit.Ne kemi mijëra euro humbje çdo vit që na padisin nëpër gjykata për me kërku dëmin e tokës që e kemi shtru ne.Duhet qeveria ose mekanizmat tjerë me bë një zgjidhje.

Liridon Fandaj - me këtë projekt-vendim ne e kemi bë edhe një telashe tjetër sepse rregullimi i infrastrukturës në rrugën Luigj Nikolla ,4 kontrata i ka dhe pak a shumë sa e pash vendimin pronari po jep më shumë se sa po merr.Ky këmbim po bëhet me asfalt të shtruar apo si është? nuk e di që dikush jep më shumë e merr më pak.

Armend Krasniqi - pjesën për të cilën jemi duke biseduar në lidhje me këmbimin që ka ndodhur,e kemi inicu si procedure,ka ardhë një kërkesë dhe faktikisht ka desht me na padit për me marrë pronën e atij që e kemi shtru me asfaltin ose kubëza dhe paret me i marrë prej përmbaruesit mirëpo e kemi gjet një zgjidhje.E kemi pas një pjesë të komunës vjerrinë dhe kemi vendos me negociu si rast dhe me gjet një zgjidhje.E kemi inicu procedurën për këmbim,kemi dal në teren dhe i kemi bë matjet dhe në matje kemi konstatu që ai po i bie me i dhënë 40 m² më shumë mirëpo në kuadër të 40m² që i ka dhënë e ka bë një deklaratë prej 7.559.00 € dhe ia ka fal komunës së Suharekës.

Liridon Fandaj - sa është pjesa e investimit publik aty që është bë me 4 kontrata?A është e shtruar?

Armend Krasniqi - po është e shtruar dhe atë pjesë të shtruar e ka marrë komuna.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 4.

23 për,1 kundër,1 apstenim, Miratohet pika 4

Pika 5. Shqyrtimi i projekt-vendimit për dhurimin e llaptopave;

Kryesuesi - pasi nuk ka debat Kryesuesi e hedh në votim pikën 5.

Me 22 vota për miratohet pika 5

Pika 6. Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës;

Kryesuesi - elaboron pikën dhe kërkon popozimet nga partitë politike.

Aziz Bytyqi - propozojmë Vullnet Luzhnica.

Doruntina Zenelaj - propozojmë Elmaze Bytyqi.

Sheqerije Zyrapi- propozojmë Dardan Berisha.

Laureta Tafaj - nuk kemi propozim.

Jehona Rrafshi - propozoj Jehona Rrafshi.

Herolind Limaj - nuk kemi propozim.

Kryesuesi - e hedh në votim propozimin për Vullnet Luzhnicën.

15 për,3 apstenime

Kryesuesi - e hedh në votim propozimin për Elmaze Bytyqin.

8 për,2 kundër,9 apstenime

Kryesuesi - e hedh në votim propozimin për Drdan Berishën.

16 për,2 apstenime

Kryesuesi - e hedh në votim propozimin për Jehona Rrafshin.

10 për,5 apstenime

Kryesuesi konstaton që nga legjislativi shkojnë Vullnet Luzhnica dhe Dardan Berisha.

Kryetari - nga ekzekutivi propozoj Besa Kuçi dhe Armend Krasniqi dhe nga shoqëria joqeveritare Erëza Muqa.

Kryesuesi - hedh në votim komisionin me këtë përbërje: Vullnet Luzhnica, Dardan Berisha, Besa Kuçi, Armend Krasniqi dhe Erëza Muqa.

13 për, 4 kundër,2 apstenime

Miratohet pika 6

Pika 7. Shqyrtimi i projekt-vendimit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës;

Kryesuesi - e elaboron pikën dhe hap debatin. Nuk ka debat, Kryesuesi e hedh në votim pikën 7.

22 për,1 kundër, Miratohet pika 7.

Pika 8. Pyetje dhe përgjigje;

Urim Suka - mbledhjen e kaluar unë kam kërkuar nga ky pushtet dy rapore dhe asnjëra nuk më ka ardhë dhe ky është një shqetësim jashtëzakonisht i madh dhe nëse nuk marrim përgjigje kjo duhet të na shqetësojë të gjithëve sepse është një papërgjegjësi dhe një moslogaridhënie e ekzekutivit ndaj neve si asambleist për çka jemi të thirrur me mbrojt interesin qytetar. Ndër raportet që kam kërkuar është raporti nga Drejtoria e Kulturës për subvencionet për vitin 2023. Subvencionet që janë dhënë në vitin 2023, a janë

implementu ato projektet sipas asaj që janë dhënë?Raporti tjetër ka qenë raporti që e kam kërku nga Kryetari dhe Drejtori i Arsimit,i cili ka të bëj me organizimin e maturantëve.Kam dasht ta dijë se si ka shkuar ai organizim dhe pyetjet i keni në procesverbal.Shqetësimet që dua ti ngris sot,2 prej tyre kanë të bëjnë me ndriçimin publik.Nga përfaqësuesit e fshatit Sllapuzhan kam marrë një shqetësim ku aty ka dy javë që ndriçimi publik nuk funksionon.Pse ajo nuk funksionon dhe kur pritet që ajo të bëhet funksionale që qytetarët atë investim ta gëzojnë.Në fshatin Bllacë te lagjja “Suka” është bërë parku i lodrave.Fëmijët e kanë gëzu atë edhe pse cilësia ka qenë shumë e dobët,është provu me u renovu por nuk është renovu e gjitha.Aty është vendos edhe ndriçimi por ndriçimi kurrë nuk ka funksionu aty.Janë vendos dritat e reja dhe as këto nuk janë funksionale.Kjo e paraqet një papërgjegjësi tepër të madhe që unë çuditem.Ku kanë shku ato dritat sepse ato kanë qenë të reja dhe të papërdorura,pse kanë ardhë tjerat dhe pse prap nuk janë funksionale?Shqetësimi tjetër ka të bëj me DKA-në për përgaditjet për fillimin e vitit të ri shkollor.Unë e kam pa një kontratë që DKA e ka lidh me një kompani për investime në disa shkolla dhe ajo që më shqetëson është që të hënën mësimi në shkollën e Bllacës ka me u zhvillu me dy ndërrime për shkak se kompania që e ka marrë punën ende nuk e ka kry punën.I kemi pas 2 muaj pushim,nuk kanë mjaftu dhe si rezultat i një papërgjegjësie të madhe të DKA-së dhe gjithë procedurave që janë vonu,ne sot kemi malltretimin e fëmijëve,të mësimdhënësve dhe mësimi nuk fillon sipas asaj që është dasht me fillu.Pse ka ndodh një gjë e tillë dhe kur pritet që këto punë me u kry sipas kontratës që janë dhënë? Në një seancë të kaluar përpjekja e Drejtorit të Katsrës ka qenë e madhe për me fut një pikë në rend dite edhe ne nuk e kishim asnjë informatë por pranuar gati me mbajtë seancë të jashtëzakonshme që të vje ajo pikë sepse na u duk intersant ajo lëndë.Nuk është thirr seancë e jashtëzakonshme dhe as në seancë të rregullt nuk ka ardhë ajo si pikë në rend dite.Le të na informojë drejtori se ku kanë mbet procedurat me këtë pikë.

Armend Krasniqi - unë e thash që po e fusim në seancë të jashtëzakonshme për shkak se nuk kemi kohë të mjaftueshme,ju nuk pranuat dhe unë obligimin tim e kam kry.Me AKP-në kemi komunikuar,e kemi dëgu listen zyryare dhe jemi duke e prit një përgjigje që me na dhënë edhe një shancë që me sjell në Asamble.

Kryetari - parku në Bllacë te lagjja “Suka” i ka 5-6 vite dhe kuptohet që çdo gjë don mirëmbajtje dhe dëshira më e madhe ka qenë me shfrytëzu fëmijët por për ndriçim nuk e di që qenka vendos një ndriçim i ri.Është një menaxher i kontratës.Sa e di në Sllapuzhan janë vendos drita të reja dhe a funksionojnë,unë e di që funksionojnë por mund të gaboj sepse edhe siguresat dalin nga sistemi ose e prek dikush siguresat.Te pyetja tjetër,mbrëmjen e maturës me tri shkollat e kam organizu dhe ka me organizu çdo vit si Kryetar i Komunës.Çështjen e sigurisë e ka policia dhe jo komuna.Te subvencionet,unë e di që janë në faqe të komunës të gjitha me emra dhe mbiemra.E kam obligim ta paraqes një problem para jush që këtë vit afërsisht 70.000€ të subvencioneve që janë nda me vendim të komisionit janë marrë nga Thesari i RKS-së por janë marrë edhe komunali,investime kapitale,pra vetëm muajin e kaluar janë marrë afërsisht 3.2 milion mirëpo kjo nuk ndodh vetëm në komunën e Suharekës për shkak të kontratave kolektive.E dini që kanë fillu procedurat,janë duke u punu punët në teren mirëpo ne në fund duhet ti përmbledhim me një raport dhe ti bartim si borje vitin e ardhshëm sepse ato janë obligime që duhet ti kryejmë.

Remzi Bajselmani - DKA pas përfundimit të procesit mësimor menjherë në korrik ka fillu me përgaditjet për fillimin e vitit të ri shkollor.Pas kërkesave të disa shkollave është konstatu që në 5 shkolla ka nevojë me pas renovim dhe njëra ndër to është shkolla “Ramë Bllaca” në Bllacë ku kanë fillu punimet dhe kanë kriju një shqetësim.Punëkryesi ka heq lineliumin e 8 klasëve dhe është konstatu që i gjithë hibercuku është i thyer dhe menjëherë ka bërë kërkesë që ajo të shtrohet por është një çmim i cili del nga kontrata.Gjatë javës jam përpjek me kontaktu punëkryesin dhe menaxherin e kontratës por nuk kanë qenë këtu.Nesër do të dal në teren në Bllacë ku do të konstojmë se cilat klasë bën me u shtruar me epofiks dhe në 3-4 klasë duhet me pas një paramasë shtesë për ti rregullu dyshemetë.Drejtori tuje jep sqarime dhe thotë që edhe në 2-3 shkolla kanë dalë kësi lloj probleme.Në Bllacë ka ndodh kjo vonesë për shkak të vonimit të procedurave të prokurimit.Madje kemi konstatu që ka pas kabinete,biblioteka etj. për me i shfrytëzu por shkolla ka konstatu që për një periudhë me kalu me dy ndërrime.

Urim Suka - Drejtori i Katastrës moti ka fillu me u krekos,edhe i Urbanizmit dhe ju sot.Por e vërteta është që faktet jam duke i thënë unë.Ju e thatë që procedurat i keni fillu në korrik dhe ju është dasht që procedurat ti filloni në prill kur e dini çka ke me bërë gjatë verës dhe jo javën e fundit.Paratë që i keni në menaxhim,ju jeni për me i menaxhu mirë.Drejtori Armend u lidh me filozofinë që unë nuk kam lidhje por

nuk më dha përgjigje. Në aspektin e asaj që më tha Kryetari te parku i lodrave te lagjja “Suka”, Kryetar kurrë ato drita nuk janë dhez dhe ato janë ndërru dhe prap nuk po bëjnë dhe edhe më keq që nuk e din. Edhe për Sllapuzhan po thua nuk e di. Shko dhe konstatoje. Unë e kam faktin. Sa i përket subvencioneve ti më the që është lista kujt ia keni dhënë subvencionet. Unë e di kujt ia keni dhënë sepse drejtoresha ma ka dërgu raportin me kërkesën time por këtë që e kam kërku tash është se a janë realizu ato projekte? Për pjesën e maturanëve, nuk jam kundër organizimit të maturanëve. Nuk të kam kërku përgjigje por raport me shkrim. Ti po i ik raportit, ti po i ik përgjigjes dhe nuk është e jotja me i thirr maturanët andej këndeje por është e këshillave të prindërve, e këshillave të klasës, e këshillave të shkollave me i organizu ato dhe nëse këto iniciativa burojnë nga ta, mirë se vine. Por ne e dim që ti e ke bo dhe bjere një raport mbi bazën e pyetjeve që ti kam bo në atë Asamble dhe jemi në rregull.

Kryetari - a ka më mirë se në mënyrë publike me thënë me gojë. E kam përgjegjësinë që unë e kam organizu dhe kuptohet që ka shku një organizim përmes Drejtorisë së Arsimit, Drejtorisë së shkollve.

Urim Suka - Drejtori i Arsimit e ka mohu si aktivitet. U bë një binë aty dhe kush e ka pagu?

Kryetari - komuna.

Urim Suka - kanë ardhë këgëtar aty, kush i ka pagu?

Kryetari - bizneset.

Urim Suka - ato nëse mundesh me na sjell me një raport të thjeshtë.

Armend Krasniqi - sa i përket përgjegjes ishte më se e qartë. Sa i përket Drejtorisë së Pronës jam në gjendje çdo ditë që nga dita e parë e fillimit të punës e deri sot me dhënë raport. Unë ta tregova arsyen pse kam kërku me fut pikën shtesë dhe cili ka qenë interesi i komunës mirëpo afati që ka pretendu AKP-ja nuk na ka leju dhe tash e kemi dëgu një kërkesë te AKP-ja dhe nëse na lejon e sjellim në një seancë të rregullt.

Urim Suka - një diçka që ka thënë me fut në rend dite, ne kërkuam dy ditë që ta lexojmë dhe i thamë: thirrna në seancë të jashtëzakonshme, do të vijmë. As në seance të rregullt nuk e solli dhe tash po thotë nuk është gati dhe po më fajson mua.

Armend Krasniqi - Drejtori prap jep sqarime sa i përket pyetjes.

Liridon Fandaj - para dy mbledhjeve ia kam bërë një pyetje Drejtoreshës së Inspeksionit për një rrënim që është bërë në rrugën “Skënderbeu”. Drejtoresha është përgjigj që aty ka vendim për rrënim dhe objekti që është rrënu ka qenë në parcellë publike. A ka dal Drejtoresha me kqyr rrugën “Skënderbeu” sepse në rrugën “Skënderbeu” ka që janë duke ndërtu dhe mos janë duke ndërtu prap pa leje dhe duhet me shfrytëzu fondin publik për rrënim? Pyetje për Drejtorinë e Shërbimeve Publike: para disa dite e kam pa në mendja deponinë në Shirokë dhe mes tjerash ka qenë një qytetar aty që e ka pas një ankesë që ai është infektu nga era që kundërmon aty për shkak se aty hudhen edhe mbetjet e shtazëve dhe ai ka një raport që është infektu prej asaj deponie. Kush e menaxhon atë deponi dhe Drejtoria e Inspeksionit a ka marrë masa ndaj keqpërdoruesve që me një deponi hudhin diçka që nuk është e lejuar?

Albulena Kokollari - është e vërtetë që muaj më parë është bërë një rrënim në pronën publike. Sa kam informacion asnjë ndërtim nuk është duke ndodh deri tash në rrugën “Skënderbeu” pa leje. Kanë fillu dhe janë ndërpre prej Drejtorisë së Inspeksionit të gjitha ndërtimet që kanë qenë ilegale. E di që është bërë një ndalim i punës dhe ka filu me u pajis me leje por nuk e di a u pajis ende por është në prag të lejes.

Liridon Fandaj - specifikisht thashë në parcelën ku ju e keni bërë rrënimin sepse unë e kam vizitu dhe pikërisht tash të ftoj ta vizitosh.

Albulena Kokollari - ndërtimi që po thoni ju është në pronë private dhe ajo është në kërkesë për marrjen e lejes.

Liridon Fandaj - atë informatë e kërkoj zyrtarisht që ti me sjell një vendim për rrënim.

Jehona Lumi-Rafshi - po i drejtohem Drejtoreshës së Inspeksionit ku kam një propozim. E kam pa një shpallje publike që është bërë për operatorët transportues për autobus për linja të reja e cila ka qenë shumë e nevojshme dhe e përgëzoi për këtë. Kërkoj që çdo shpallje publike që bëhet pos nisjes që është parapa kërkohet edhe kthimi. Këtë e kërkon rrgullorja dhe ligji i punës për shkak se rendi i udhëtimit e parashih edhe nisjen edhe kthimin dhe këta e kanë parapa vetëm nisjen. Propozoj të rregullohet nëse është e mundëshme.

Kushtrim Kuçi - kam bisedu edhe me Visarin i cili ka qenë përgjegjës për ndriçimin në qytet dhe në momentin kur ka fillu kompania me realizu ndriçimin në qytet shqetësimi i qytetarëve të lagjes “Gradina” ka qenë se ndriçimi është i vendosur por në momentin që kanë fillu ti bëjnë disa instalime,e kanë ndërpre rrjetin.Kam bisedu edhe me drejtorët por nuk është bërë intervenim.A ka mundësi ta merrni parasysh këtë.

Rrjeti që po vendoset nën tokë është kompetencë e KEK-ut,a ka mundsi komuna me bërë kërkesë edhe për rrugën”Hajdin Berisha” sepse telat e rrymës janë shumë afër objekteve?

Alban Berisha - kam kërkesë drejtuar Kryetarit.Mirë që janë bërë disa investime nëpër lagje por gjithmonë edhe masat preventive janë më të mira para se me ndodh një e keqe.Në lagjen ku jetoj unë dhe në shumë lagje tjera janë shtrur rrugë,u bërë një infrastrukturë e mirë dhe normal ka edhe të meta.E meta më e madhe është se nuk ka sinjalizime dhe as nuk ka pengesa dhe vërtetë rrezikohen fëmijët sepse veturat vozitin shumë shpejtë.Propozoj që të bëhet një lini e parkingjeve dhe edhe të lëshohen me qera sepse nuk ka asnjë të keqe.Kjo e pengon pak komunikacionin mos me u zhvillu shpejt dhe i krijohet parking qytetarëve dhe normal me pas të drejtë ata banorë para shtëpisë së tyre kundrejt një pagese sa do që është dhe me pas si parking privat.Nëse e lejon rregullorja,me shqyrtu sepse i ka dy të mira: Ofrohet parking dhe lirohen trotualet për qytetar. Po thuhet që në gjimnaz pak është problematike numri i nxënësve,nuk ka shumë kërkesa. A ka të bëjë kjo me orientimin e nxënësve në ato drejtime,a ka të bëjë që është një personel shumë më i kualifikuar andej apo ka të bëjë me skandale të kohëve të fundit?Ju si drejtori çfarë masa keni marrë që dasht e pa dasht pavarësisht vendimit që është marrë,pavarësisht përfundimit që ka ndodh në ato skandale,ato akuza që dyshohet që kanë ndodh ,me ia kthyer reputacionin gjimnazit apo me atë që ka përfunduar ajo punë.Nuk jam duke paragjyku që ka ndodh diçka por nuk po shoh asgjë në atë drejtim,me ia kthyer reputacionin për të mirë.Drejtor po pres prej juve si ekspert me bërë diçka më shumë sepse gjimnazi nuk është në piedestalin që duhet me qenë as si emër,as si objekt,as si subjekt,as si personel.Nëse sot nuk jeni të përgaditur për këtë temë,kisha pas dëshirë që në mbledhjen në vijim me pas më shumë informatë rreth gjimnazit sepse ajo temë ka kalu shumë shpejtë dhe shumë lehtë dhe nuk ka qenë një akuzë e lehtë.

Remzi Bajselmani - jam i përgaditur për këtë temë me u përgjigj sepse kam punu dy muaj në këtë drejtim për regjistrimin në gjimnaz.Është fakt që janë regjistruar më pak nxënës se parashikimi.Janë parashiku m'u regjistru 5 klasë në drejtimin shkencat natyrore dhe 5 klasë në shkencat shoqërore.Në shkencat natyrore janë regjistru 5 klasë ndërsa në shkencat shoqërore nuk janë regjistru se s'ka pas nxënës. Është edhe një arsye që gjimnazi zbaton kriteret,i regjistron vetëm nxënësit që janë të shkëlqyeshëm dhe me katër.Nëpër shkollat e mesme të ulëta nuk ka nxënës shumë me rezultate të shkëlqyeshme.Një pjesë të nxënësve të shkëlqyeshëm na kanë marrë drejtimet e mjekësisë në Shirokë por edhe nuk ka nxënës më shumë dhe interesi i nxënësve dhe i prindërve nuk është me i regjistru në shkencat shoqërore sepse nuk shohin ndonjë perspektivë.Për këtë arsye jemi marrë me sistemin e stafit të gjimnazit dhe fatmirësisht asnjë mësues nuk del jashtë sistemit me 2 shtator.Sa i përket asaj pjese që theksohet,janë marrë organet e hetuesisë,kanë sjellë një rezultat,është marrë një komision dhe ka dhënë një vendim për atë dhe s'kemi pas fakte tjera për me marrë masë më të theksuar.

Kryetari - te lagja e re që theksohet,duhet me dalë një ekip ekspertësh të komunikacionit dhe me bo një rrugë njëdrejtimëshe për me nxjerr parkingje.Sa i përket shenjëzimeve,ende nuk është përfunduar mirëpo ne duhet me vendos tabelat deri në 30 në orë.Policia duhet me fillu me dënime se ndryshe s'mund ti ndalim.

Laureta Tafaj - para 5 dite në oborr të QKMF-së është pa një pacient i cili është dalë në oborr me marrë infuzionin.Pacienti me infuzion nuk guxon as me dalë jashtë e as me shku në shtëpi.Nëse ai ka insist me u largu prej dhomës ku ka qenë duke marrë infuzionin,atëherë ekipa mjekësore është e detyruar me ia heq infuzionin dhe me liru pacientin.

Kryetari - para 10 dite kam shku në ora 11:15 dhe së paku kanë qenë 100 pacient duke prit në koridor dhe brenda kanë qenë 7 shtretër ku pacientët kanë qenë duke marrë infuzion.Duhet të na kuptoni sepse muajin korrik dhe gusht rritet numri i qytetarëve dhe kemi ahengje familjare,po ndikon edhe ajri dhe është e pamundur me i përcjell të gjitha kapacitetet në atë kohë.

Laureta Tafaj - e kuptojmë fluksin por kur e din që ka me ndodh ajo atëherë ke hapësirë mjaftueshëm në QKMF lart,në dhomë të doktorit ku nuk punon.

Mimoza Bajraktari - është shumë e vërtetë që infuzioni nuk guxon të merret në hapësirat e jashtme por e cekët muajin korrik dhe gusht që janë të ngarkuar për kapacitete që ne i kemi si njesi familjare apo si

urgjencë. Edhe përkundër kësaj jemi duke kry punë më shumë se që duhet. Në orën 10 mjekësia familjare mbyllet ku e kemi dhomën e observimit ku aty kemi 7 shtretër. Pacientët të cilët janë në observim nuk guxojmë m'i lënë aty pa përkujdesje të stafit mjekësor. Momentin që po kalojnë në urgjencë, urgjenca i posedon 4 shtretër ku munden me i marrë infuzionet dhe 3 shtretër të tjerë të cilat janë për raste emergjente ku nuk guxojmë me i blloku edhe pse ka raste ku i bllokojmë edhe 2 shtretër tjerë dhe 1 e lëmë për raste emergjente. Unë jam e bindur që fotot në cilën edhe vet e pash, ishte në orët e vona. Ai pacient duke kalu nga dhoma e observimit është ul aty sepse ka pritu me shku anej dhe stafi ka qenë e pamundur me pa. Pacientët të cilët kërkojnë me infuzion të shkojnë në shtëpi, detyrohen të nënshkruajnë në protokole gjë që prap është e paligjshme. Sa i përket shfrytëzimit të hapësirave tjera, në mjekësinë familjare i posedojmë 5 dhoma të mjekëve dhe të 5-stat janë në shfrytëzim për vizitat mjekësore. Në pjesën lart të objektit e kemi gjinekologjinë, radiologjinë dhe zyrën time dhe pjesën e gjinekologjisë nuk guxojmë me shfrytëzu.

Laureta Tafaj - sa i përket punës që e bëjnë infermierët dhe doktorët aty jemi më se të kënaqur por unë fola për menaxhimin. Nëse doktorri dhe stafi shkojnë në ora 10 atëherë ato dhoma janë të qytetarëve, nuk janë pronë e doktorrit ose askujt tjetër. Në raste urgjente që pacienti mos me dal jashtë, futne në dhomë të doktorrit.

Mimoza Bjraktari - ne mund ta lëmë te dhoma e observimit por po kanë largësi me emergjencën dhe nëse ndodh diçka me atë pacient duke e marrë infuzionin, pa mbikqyrje të stafit mjekësor prap përgjegjësia kalon tek ne. Mimoza Bjraktari tutje jep sqarme.

Selman Kolgeci - tek ndërtimi i tregut lart, në renderat e atij projekti e kam pa që fillimisht është pozicionu në anën tjetër. A ka ndodh gabim në projekt apo është ndërru lokacioni? Nëse është ndërru lokacioni, me çfarë arsytimi dhe a ka pëlqim prej KED-sit për shkak se aty kalon tension i lartë dhe a ka rrezik në kohën kur shfrytëzohet tregu? Çështja tjetër është te sheshi. Pse po zvarriten punët në shesh? Aty kanë kalu plani dinamik. Çështja tjetër tek sheshi është se në thirrjen e tenderit që e ka publiku komuna e Suharekës është se aty kanë kërku makineri me i pas kompania. Ku janë ato makineri sot që ne s'po shohim asgjë tjetër përpos një fleksi. Çështja tjetër ka të bëjë me rrënimin e objektit te Mulliri i Beqës. Unë kam bërë kërkesë zyrtarisht me ditë a ka qenë objekt në mbrojtje të trashëgimisë kulturore dhe e njejtja m'u ka përgjigj që ka qenë objekt në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore. Si ka mundësi me u rrënu një objekt i cili është në mbrojtje të trashëgimisë kulturore dhe inspektorat, Kryetari e gjithë tjerët mos me pa këtë gjë! A janë respektu distancat, rrezja e caktuar në hartë zonale dhe në ligjin e ndërtimit për dhënie e lejes së ndërtimit të objekteve rreth atij objekti?

Kryetari - mulliri sa e di unë ai kur ka hy në ruajtje nuk ka ekzistuar. Kryetari jep sqarime edhe sa i përket sheshit dhe tregut.

Selman Kolgeci - si një objekt në mbrojtje dhe Kryetari nuk e din që ka ekzistuar!

Kryetari - një kohë ka qenë por kur ka hy ky nuk ka ekzistuar.

Flamur Bytyçi - në bazë të informacioneve që unë kam, mbi 3.000.000€ përmbaruesi privat i ka marrë dhe deri tash asnjë sqarim nuk e kemi marrë ne si asambleista. Prej cilave projekte i ka marrë përmbaruesi këto mjete? Pse s'e keni përdorur metodën e ndërmjetësimit por e keni rritur vlerën e kësaj shume edhe pse unë besoj që kjo vlerë ka m'u rritur dita ditës më shumë. Realisht kanë me u dëmtu shumë qytetarët.

Kryetari - paret neve na i kanë marrë nga thesari. Mandatin e kalaur e kemi marrë një vendim për me i pagu paret e ushqimit dhe mbas 6 muaj kanë thënë që është shkelje. Pastaj e kemi shpall për me gjet një kompani transportuese, e kemi marrë por asnjë arsimtar a'ka dasht me hip në autobus por në fund i kanë kërku paret dhe e kemi pa që nuk shkon kjo dhe e kemi ndërpre kontratën. Ministria e Financave përcakton limitet sa kemi me shpenzu dhe sa kemi me marrë.

Elmaze Bytyqi - a mundeni me bisedu ju me Ministrinë e Financave që me i orientu ju që ku me i marrë ato pare?

Kryetari - e kemi bisedu shumë herë. E ka marrë komplet buxhetin e 21-shin, e ka marrë komplet 22-shin, ka marrë subvencione, ka marrë mallra dhe shërbime, ka marrë komunal.

Flamur Bytyçi - te pjesa e arsimit, mësimdhënësve, unë e di që është obligim ligjor me ia plotësu normën mësimdhënëse, pse vazhdoni me marrë mësimdhënësa të ri për deri sa dikën e lini me normë më pak?

Remzi Bajselmani - nuk ka kërkesa për plotësim norme.Nuk kemi shpall konkurse për deri sa kemi pas mësimdhënës në sistem.

Urim Suka - ditë më parë më ka ardhë një video ku një qytetar pasi ka marrë infuzionin në ambulantë dhe për shkak që u kry orari i punës atje,u detyru me shku në emergjencë.Ai ka qenë bashkë me nënën e tij dhe kur ka shku te emergjenca ka pas shumë pacientë por është shumë e papranueshme ku ata e kanë lënë me dal jasht.Ai ka dal jasht,qytetari u ul në ulëse e ka marrë infuzionin ndërsa nëna e tij e ka marrë infuzionin në kerr.

Mimoza Bajraktari - niveli parësor nuk ka të drejtën as mi shtri pacientat e me dhënë infuzione por për shkak të kohës së kovid-it ta ka dhënë ministria një të drejtë për me i kry këto shërbime.Kemi rast që komplet familja vjen për shkak se ka qen një virus i madh.Si me lënë mjekësinë familjare,kënd me obligu prej stafit deri në 12 të natës ku të gjitha ato janë femra.Mimoza Bajraktari tutje jep sqarime.

Qëndrim Elshani - dua ta hap një temë e cila nuk është hap asnjëherë në asamblenë komunale.Dua ta hap temën e lojërave të I-sportit.Ndoshta për një moshë të shtyrë nuk janë sepse nuk i kanë luajt kur kanë qenë të ri dhe nuk e dine por rinia janë shumë të mirë në lojërat e I-sportit.Kisha kërku prej Drejtoreshës së Kulturës me bo një turnir që afron,që i avancon lojëtarët e I-sportit se vërtetë në Suhareka ka shumë talenta në këtë fushë. I jap një kritikë drejtoreshës që në të ardhmen kur të shpërndahen mirënjohje për sportistat e dalluar ,me dhënë mirënjohje edhe për lojëtarët e I-sportit.Për këtë unë jam i gatshëm 24/7 me dhënë krejt njohurinë time dhe kohën për me dal mirë Suhareka sepse besoj që ia vlen.

Lorika Gashi - çështja që e ke hap është shumë e rëndësishme dhe jo të gjithë mund ta kuptojnë dhe pranojnë që intelgjenca artificial çdo ditë po na bëhet pjesë e jetës.Pavarësisht pjesës së sportit edhe I-sporti është njëra prej sporteve më të pëlqyera prej të rinjëve.Nuk pajtohem plotësisht sepse i ka edhe penalizimet e veta por është diçka që të rinjtë kanë përfitime prej atyre lojërave dhe kanë aktivitete të ndryshme.Në Suharekë me sa kam informacion unë nuk kam pas as kërkesë për regjistrim të një klubi ose OJQ-je që me qenë në mënyrë zyrtare dhe që të ketë edhe përkrahjen institucionale dhe pse edhe subvencionimin ose edhe pjesë e sportistit të vitit.

Qëndrim Elshani - nëse jeni e gatshme unë zotohem që deri mbledhjen e radhës të asamblesë me ardhë me një plan të veçantë për integrimin,për përkrahjen e këtyre lojtarëve të I-sportit.

Lorika Gashi - unë jam e gatshme me u taku me ta dhe me pa se çka mund të bëjmë.

Takimi përfundoi: 12:50

Procesmbajtësja:
Dafina Haziraj